



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Pimljeño/Prodato Received/Delivery	16-05-2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SLAMSTICK	4261/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.670/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktar-Kryetare, Arben Mehmeti, Ardita Haxhnikaj-Demi-Anëtarë dhe Kaltrina Avdullahi Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.670/2023 të datës 25.04.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë:

kundër njoftimit për kandidatin e suksesshëm të datës 28.03.2023 për pozitën, “Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan”, në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në çështjen juridike, “Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.05.2023, morri këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.670/2023 e datës 25.04.2023 e parashtruar nga ankuesja.

A r s y e t i m

Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me datë 30.01.2023 ka shpallur konkursin për pozitën e lirë “Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan”. Pas përfundimit të procedurave të rekrutimit me datën 28.03.2023 Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka bërë njoftimin për kandidatin e suksesshëm të rekomanduar nga Komisioni Përzgjedhës.

Ankuesja, e pa kënaqur me njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 28.03.2023 për pozitën, “Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan” në Sekretariatit e KQZ-së, me datë 25.04.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokollit Nr.09/537-2023 në Komisionin për ankesa të Sekretariatit të KQZ-së.

Ankuesja po ashtu në të njëjtën ditë konkretisht me datë 25.04.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3796/2023 edhe në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 02.05.2023 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjidhjeve të KQZ-së. Ndërsa Këshilli, me datë 12.05.2023 përmes shkresës zyrtare E-mail është njoftuar nga Udhëheqësja e Divizionit për Personel dhe Shërbime të Përbashkëta, se Komisioni i ankesave në Sekretariatit e KQZ-së, ende nuk ka marrë Vendim lidhur me ankesën me numër protokoll Nr.09/537-2023, të datës 25.04.2023 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesa me numër A.nr.670/2023 e datës 25.04.2023 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 28.03.2023; E-mail i datës 29.03.2023; E-mail i datës 28.03.2023; E-mail i datës 30.03.2023; Shkresë zyrtare e datës 31.03.2023 nga KQZ; Kërkesë për Qasje në Dokumente Publike e datës 03.04.2023; E-mail i datës 13.04.2023; E-mail i datës 03.03.2023; E-mail i datë 14.04.2023; Përgjigje në Kërkesë me numër Nr.02/3651A-2023 e datës 14.04.2023; Kërkesë për fillimin e rekrutimit i datës 30.01.2023; Konkurs i datës 30.01.2023; Regjistri i aplikacioneve të pranura me numër reference Nr. KQZ 06/2023 i datës 30.01.2023; Shkresë për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë me numër të referencës Nr. KQZ 06/2023 e datës 07.03.2023; Shkresë për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në testin me shkrim dhe intervistën me gojë me numër reference Nr. KQZ 06/2023 e datës 15.04.2023; Shkresë për përmbledhjen e vlerësimeve individuale me numër reference Nr. KQZ 06/2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve me numër reference Nr. KQZ 06/2023; Kërkesë për punësim me numër reference Nr. KQZ e datës 14.02.2023; Testi me shkrim i datës 15.03.2023; E-mailat zyrtar të datës 14.04.2023; E-mail i datës 19.04.2023; E-mail i datës 24.04.2023; Lista e bizneseve aktive në Lipjan e datës 28.07.2020; Njoftim; Listë e OJQ-ve vendore e datës 20.04.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 02.05.2023; E-mail zyrtar i datës 12.05.2023; Ankesa me numër protokoll 09/537-2023 e datës 25.04.2023 drejtuar Komisionit për ankesa në Sekretariatit e KQZ-së.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses, *është e palejuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në Aktgjykimin Ref.Nr.AGJ 1363/19 të datës 20.02.2019 të Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Aktgjykimin KO203/19 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetues të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht duke ju referuar pikës III të dispozitivit të këtij aktgjykimi ku është përcaktuar se: *Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet në*

raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokuroria të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Mediave, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë, dhe pikës 207 po të këtij aktgjykimi ku theksohet se: *Institucionet e Pavarura kushtetuese, bazuar në Kushtetutë, janë të autorizuar që të vendosin për organizimin e tyre të brendshëm duke përfshirë rregullimin e disa specifikave lidhur me personelin e tyre, që të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative. Andaj, Gjykata theksoi se, sipas Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse, si dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, të elaboruar detajisht në Aktgjykim, ndaj Personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese aplikohen rregullat e shërbimit civil për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre”, Kolegji vlerëson se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligji Nr.06/L-114 për Zyratet Publikë, në raport me institucionet e pavarura kushtetuese zbatohen aktet e tyre të brendshme dhe Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për aq sa nuk cenohet pavarësia e tyre.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të dëshmimeve të ofruara nga organi i punësimit konkretisht Njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 28.03.2023 për pozitën *“Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan”*, në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka konstatuar se institucioni në fund të njoftimit ka udhëzuar kandidatet e pakënaqur se mund të ushtrojnë te drejtën e ankimimit në Komisionin e Ankesave të Sekretariatit të KQZ, ashtu siç është përcaktuar si në vijim: *“Duke u bazuar në nenin 49 pika 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 03/207 për Procedurat e Rekrutimit në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ju njoftojë se një nëpunës ose kandidat në një procedurë të rekrutimit është i pasuksesshëm dhe nuk emërohet në pozitën përkatëse dhe ai/ajo mendon se emërimi i një pësoni tjetër në atë pozitë, nuk është bërë në bazë të meritës ose është bërë si pasojë e parregullsisve në zbatimin e rregullave dhe procedurave, ai/ajo mund të ankohet me shkrim në Komisionin e Ankesave të Sekretariatit të KQZ-së, i cili shqyrton dhe vendos për ankesën brenda 30 ditëve nga data në të cili vendimi për përzgjedhje dhe emërim shpallet për kandidati nga institucioni përkatës”.*

Mbi bazë të provave të lëndës Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se ankuesja me datë 25.04.2023 ka parashtruar ankesë me numër Nr.09/537-2023 në Komisionin për Ankesa të Sekretariatit të KQZ-së, kundër njoftimit për kandidatin e suksesshëm të datës 28.03.2023. Ndërsa në të njëjtën ditë konkretisht me datën 25.04.2023, ankuesja ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3796/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses, analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 135 paragrafi 1, është përcaktuar se: *“Përpos kur ligji parasheh një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës”*, dhe rrjedhimisht duke marr parasysh konstatimin si me lartë se ankuesja me datë 25.04.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa të Sekretariatit të KQZ-së, atëherë sipas Kolegjit të Këshillit, ankuesja ankesën e datës 25.04.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar ende pa kaluar afati i përcaktuar për përfundimin e procedurës



administrative-heshtja administrative respektivisht ende pa kaluar afati për vendimmarrje nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të KQZ-së, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa e ankueses është e paraafatshme në kuptim të nenit 16 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe dispozitave të nenit 125 paragrafi 1 dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si e tillë është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.670/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Njësisë së Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së